

**ILIRJANA KACELI (DEMIRLIKA)**

**VENDOSJA E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-TURKE  
GJATË VITEVE 20' TË SHEKULLIT TË KALUAR**

**Klima politike në prag të vendosjes  
së marrëdhënieve diplomatike**

Pas Shpalljes së Pavarësisë Shqipëria, në marrëdhëniet me Turqinë, pati një shkëputje disavjeçare. Lufta e Parë Botërore, solli si rrjedhim, jo vetëm shkatërrime për të dy vendet por edhe ndryshime në pozitën e tyre ndërkombëtare. Shqipëria në përfundim të saj duhej të ndërtonte shtetin dhe të forconte identitetin kombëtar, kurse Perandoria Osmane tanimë e dobësuar, duhej të paguante borxhet dhe llogaritë e shekujve. Fatet e tyre vendoseshin nga Konferenca e Paqes në Paris dhe nga dëshirat dhe interesat e shteteve fituese. Ecuria e punimeve të Konferencës i kishte bërë shqiptarët të mendonin se nuk kishte shpresa që diplomacia e Fuqive të Mëdha do të zgjidhte çështjen shqiptare sipas interesave të tyre.

Në këto kushte, dilte si domosdoshmëri reagimi i vetë shqiptarëve. Për këtë u vendos organizimi i një mbledhje mbarëkombëtare. Delegatë shqiptarë nga të gjitha trevat, nga 21-31 janar 1920 u mbledhën në Kongresin e Lushnjës, i cili do të miratonte qeverinë e retë kryesuar nga Sulejman Delvina, një nga personalitetet e rëndësishme politike të kohës<sup>1</sup>. Në postet kryesore ministrore u caktuan Mehmet Konica, si ministër i Jashtëm, dhe Ahmet Zogu në postin e ministrit të Brendshëm. Qeveria e Sulejman Delvinës krahas masave për konsolidimin e shtetit të ri, u përpoq të zhvillonte një veprimtari të gjallë diplomatike, për të siguruar në arenën ndërkombëtare të drejtat sovrane të Shqipërisë.

Më 17 dhjetor 1920, Shqipëria u pranua anëtare e Lidhjes së Kombeve<sup>2</sup>, hap i rëndësishëm drejt rikonfirmimit të njohjes ndërkombëtare të shtetit shqiptar dhe njëheri për njohjen e qeverisë së re,

<sup>1</sup> Mehdi Frashëri, *Kujtime (vitet 1913-1933)*, Tiranë: OMSCA-1, 2003, f.78.

<sup>2</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912-7 prill 1939), Tiranë: Toena, 2007, f.171.

si qeveri *de jure* të tij<sup>3</sup>. Njohja ndërkombëtare e shtetit të pavarur shqiptar dhe mbrojtja e tërësisë territoriale nga Lidhja e Kombeve si edhe hapat e reformimit, krijuan një klimë të favorshme që shqiptarët të përqendroheshin në ngritjen dhe forcimin e institucioneve të brendshme<sup>4</sup>. Situata ishte e koklavitur edhe në Turqi. Ekzistenca e dy pushteteve nga një anë qeveria e Sulltanit me qendër Stambollin, dhe nga ana tjetër pushteti i ri i vendosur nga nacionalistët turq me qendër Ankaranë, e bënte të vështirë qeverisjen e tij. Ndërkohë lufta kombëtare (nacionaliste) e popullit turk, për të larguar grekët, francezët, anglezët nga Anadulli po shkonte drejt fundit. Më 23 prill 1920 në Ankara u hap Asambleja e Madhe Turke e cila do të zgjidhte kryetar të saj Mustafa Qemalin, një shtetar dhe ushtarak të zotin. Krahas detyrës për rindërtimin nga e para të Turqisë, ai do t'i kushtonte vëmendje forcimit të lidhjeve me shtetet fqinje dhe në këtë kontekst edhe marrëdhënieve diplomatike me qeverinë shqiptare, të dalë nga Kongresi i Lushnjës<sup>5</sup>.

Nisur nga ky këndvështrim, Mustafa Qemali më 9 dhjetor 1920, për të rritur më tepër pozitat e tij por edhe për të gjetur përkrahje dërgoi në Shqipëri për vizitë një delegacion ushtarak turk prej 25 personash. Ky delegacion kryesohej nga ushtarakët Selaudin Saip [Shkoza] dhe ndihmësi i tij kolonel Hamdi Beu<sup>6</sup>. Qëllimi i delegacionit ishte të ndihmonte qeverinë e re shqiptare për të organizuar ushtrinë për mbrojtjen e vendit. Selaudin Bej Shkoza, i njohur nga Mustafa Qemali gjatë Luftërave Ballkanike, njëkohësisht ishte pjesëmarrës aktiv i klubit shqiptar të Izmirit. Gjatë vizitës në Shqipëri, ai u ftua nga Kryeministri Iljaz Vrioni të merrte pjesë si ministër i Mbrojtjes (Luftës) në qeverinë e tij<sup>7</sup>. Ai duhej të ngrinte një ushtri shqiptare të ngjashme me ushtrinë

<sup>3</sup> Duke iu referuar të drejtës ndërkombëtare, pranimi i një shteti në Lidhjen e Kombeve është interpretuar si një formë kolektive e njohjes së shtetit të pranuar. Për më tepër shih: Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f.291.

<sup>4</sup> Beqir Meta, "Përpyekje për konsolidimin e identitetit kombëtar në vitet 1920-1924", në: *Studime Historike*, Tiranë: 2007, nr.3-4, f.69.

<sup>5</sup> Hikmet Öksüz, "Atatürk dönemi Türk-Arnavut ilişkileri", in: *Güney Doğu Avrupa Araştırmaları Dergisi*, Istanbul: 1998, no.12 f.211.

<sup>6</sup> Selma Yel, "Atatürk ve İnkılaplarının Arnavutluk'taki Tesirleri", in: *Atatürk Araştırma Merkezi Dergisi*, Cilt XIX, sayı 55, Mart 2003, s.108.

<sup>7</sup> Necip P. Alpan, "Tarihin İşığında bugünkü Arnavutluk", Ankara: Kardeş Yayınları, 1975, f.81.

kombëtare turke<sup>8</sup>. Pas marrjes të nënshtetësisë shqiptare Selaudin Bej Shkoza<sup>9</sup>, do të zgjidhej edhe deputet i Prizrenit në Këshillin Kombëtar shqiptar<sup>10</sup>. Ai ishte i pari ushtarak shqiptar që hartoi një paketë të rëndësishme ligjore për ushtrinë shqiptare, duke hyrë kështu në historinë e saj jo vetëm si ministër Mbrojtjeje por edhe si reformator i shquar<sup>11</sup>. Selaudin bej Shkoza do të angazhohej që në fillim për formimin e një ushtrie kombëtare me 4 regjimente: në Shkodër, Tiranë, Përmet dhe Gjirokastër<sup>12</sup>.

Literatura historike vërteton se Selaudin Shkoza kishte ardhur në Shqipëri me porosi të Ataturkut<sup>13</sup>. Këtë fakt e konfirmon edhe korrespondenca midis Mustafa Qemalit e Selaudin Shkozës. Në një letër dërguar më 9 dhjetor 1920<sup>14</sup>, Mustafa Qemali i shprehte vlerësimin për pozicionin e arritur në qeverinë shqiptare si ministër i Mbrojtjes, dhe më tej argumentonte vlerat që do të kishte vendosja e lidhjeve miqësore në rang shtetëror me qeverinë e Ankarasë<sup>15</sup>.

Më 1 mars 1922, Mustafa Qemali, në një fjalim të mbajtur në Asamblenë e Madhe Kombëtare Turke duke folur për qëndrimin e popullit turk ndaj atij shqiptar “që po përpiquej për liri e demokraci”, do ta vinte theksin në lidhjet e dikurshme por edhe në perspektivën që do të kishte vendosja dhe fuqizimi i marrëdhënieve midis dy vendeve. Fjalimi do të mbahej në një kohë kur Turqia ende nuk ishte shpallur Republikë. Ataturku në këtë mbledhje do të deklaronte se: “Përsa i përket Shtetit

<sup>8</sup> *Vakit* gazetesi “*Müstakil Arnavutluk*”, 27 Nisan 1921, sayi.1216, s. 2.

<sup>9</sup> Selaudin Shkoza ishte me origjinë nga Prizreni. Ka mbaruar shkollën ushtarake në Stamboll dhe për një kohë të gjatë ka qenë gjeneral në ushtrinë osmane. Për më tepër shih: Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime Politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: Marin Barleti, 1995, f.175.

<sup>10</sup> Selma Yel, *Atatürk ve İnkılapların Arnavutluk'taki Tesirleri...*, f.108.

<sup>11</sup> Aleksander Gjinaj & F.Lila, *Lidershipi shqiptar përmes historisë së ushtrisë*, Tiranë: Geer, 2012, f.93.

<sup>12</sup> *Vakit*, gazetesine, “*Arnavutluk Yunan İhtilaf*”, 11 mayis 1921, sayi.1230, s.1.

<sup>13</sup> Halil Ozcan, *Ataturk Donemi Turkiye-Arnavutluk iliskileri (1920-1938)*, Ankara: AKDITYK Atatürk Arastirma Merkezi, 2011, f.61; Anila Polat, “Marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë dhe së sapoformuar të Turqisë (1920-1938)”, në: *HaciBektaş VeliArastirma Dergisi*, Bahar 2055/33, f.178.

<sup>14</sup> *Atatürk'ün Milli Diş Politikasi (Milli Mücadele Dönemine ait 100 Belge) 1919-1923*, T.C. Kültür Bakanlığı Atatürk Dizisi, C.1, Ankara, 1994, s.209-210.

<sup>15</sup> M. Türker Açaroglu, v.d., *Atatürk'ün Bütün Eserleri*, V.10, Stamboll: TTK 2003, f.149.

Shqiptar; për qindra vjet me radhë jetuam bashkë me popullin e këtij shteti mysliman. Për një kohë të gjatë bashkuam jetën me ta dhe patëm të njëjtin shkrim. Ky popull dhe shtet me të cilin kemi të njëjtën fe duhet ta kuptojë që kanë nevojën e mbështetjes tonë për të ruajtur ekzistencën dhe për të qenë të lumtur. Duhet të merren masa për ta shpëtuar nga kjo gjendje e vështirë që është krijuar. Këtë gjë e dëshiroj dhe e shpresoj shumë”<sup>16</sup>.

Deklarata e publikuar në shtypin turk dhe atë shqiptar do të shkaktonte reagim në Këshillin Kombëtar. Ali Bej Këlcyra një deputet me pikëpamje liberale, do t’i kërkonte Parlamentit Shqiptar që t’i deklarohet opinionit publik se nuk ka dhe nuk ekziston asnjë lidhje politike midis popullit shqiptar dhe atij turk<sup>17</sup>. Deklaratat e tij do të mbështeteshin edhe nga deputetët Kristo Dako, Refik Topija, Irfan Ohri etj., të cilët i kërkonin qeverisë shqiptare të merrnin masat e duhura dhe të kundërshtonte deklaratat e Mustafa Qemalit<sup>18</sup>.

Nuk ka dyshim se qëndrime të tilla të deputetëve shqiptarë, ndikuan jo mirë në drejtim të shpejtitimit të vendosjes së marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Turqisë së re. Më 18 maj 1921, kolonia shqiptare e Turqisë, kërkonte hapjen e një përfaqësie diplomatike në Stamboll<sup>19</sup>. Por, Kryeministri shqiptar Iljaz Vrioni këtë kërkesë do ta vlerësonte si të parakohshme. Ai do t’i shpjegonte Këshillit Kombëtar se “qeveria shqiptare nuk e sheh të arsyeshme hapjen e një përfaqësie në Stamboll, por shikon të arsyeshme për momentin, krijimin e një zyre pasaportash nën drejtimin e z. Nezir Leskoviku”. Kjo zyrë do të shërbente për pajisjen

<sup>16</sup> Sadi Burak-Utkan Kocatürk, “*Atatürkün Söylev Demeçleri*”, Cilt V, Ankara: 1987 s.42-43: shih. Necip P. Alpan, “*Turkiyeile Arnavutluk’un Istiklal Savaşları’ndaki Paralelizm Doğrultusunda Yaptıkları İşbirliği*”, X, Türk Tarih Kongresi, Cilt. 6, Ankara: 1994, s.2900-2901.

<sup>17</sup> Mejtoniu zotërinj, që fjala e përfaqësuesit të një kolonie të Anglisë mjafton ta bëjë Shqipërinë të hyjë në ligën e kombeve: një fjalë e kryeministrit të Perandorisë Britanike mjafton ta humbasë ose ta shpëtojë kombin shqiptar sot që po bisedohet fati i tij. .. Fjala e Mustafa Qemalit na bëri një dam të madh, se e bajnë të pandehne mejtimin e përgjithshëm t’Anglisë sikur Shqipëria është vegël e Turqisë. *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, Legjislatura e parë, Shkodër: Shtypshkronja “Franceskane” 1921, nr.6, f.82.

<sup>18</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, viti 1921, nr.7, f.85

<sup>19</sup> *Arkivi Qendror Shqiptar* (më tej: *AQSh*), Fondi (më tej: F.) 101, Dosja (më tej: D.) 6, Viti (më tej: V.) 1918-1924, fl.40. Telegram frëngjisht i Komitetit Shqiptar të Stambollit dërguar kryesisë së qeverisë shqiptare.

me pasaporta të shqiptarëve në Turqi, dhe kur ta lypte nevoja ajo do të mbronte të drejtat dhe interesat e shqiptarëve, atje<sup>20</sup>.

Shqetësimi për ecurinë e lidhjeve shqiptaro-turke u manifestua dukshëm në shtypin e huaj, veçanërisht në atë ballkanik<sup>21</sup>. Në artikuj të ndryshëm ngriheshin pyetje të shumta si: “Ç’farë po ndodh? Përse interesohet Ataturku për Shqipërinë? A mos po përpiqet ai ta lidhë Shqipërinë me qeverinë e Ankarasë? Ndoshta, po përpiqet të krijojë një Turqi të vogël në Ballkan?” etj.<sup>22</sup> Po kështu do të flitej edhe për oficerë të ushtrisë nacionaliste turke që vinin në Shqipëri dhe për shqiptarë që shkonin në Anadoll për të forcuar ushtrinë e re të Mustafa Qemalit<sup>23</sup>. Gazeta të ndryshme ballkanike e deri ato që botoheshin në Egjipt, të bazuara në të dhëna të shtypit anglez, do të deklararin ekzistencën e një marrëveshjeje ushtarake midis Tiranës dhe Ankarasë, me perspektivë vendosjen e një princi mysliman në fronin shqiptar<sup>24</sup>. Kjo fushatë shtypi, sipas historianit Gazmend Shpuza, ishte pjesë e taktikës së presionit dhe shantazhit që bënte në këtë kohë Foreign Office dhe qeveria britanike për çështjen e Mosulit dhe atë të tokave të pushtuara nga Greqia<sup>25</sup>. Foreign Office, do t’i bënte presion të drejtpërdrejtë në atë kohë edhe Mehmet Konicës, përfaqësuesit shqiptar në Londër, duke i kërkuar që qeveria shqiptare të merrte masa të rrepta për të ndaluar çdo propagandë qemaliste në Shqipëri<sup>26</sup>.

<sup>20</sup> *AQSh*, F. 101, D. 8, 3 korrik 1920, Ministria e Jashtme vendosi hapjen e zyrës së pasaportave në Turqi.

<sup>21</sup> *Po aty*, F.151, V.1922, D. 61, fl.1, Paris, 10 janar 1922, Deklaratë e zyrës së shtypit shqiptar.

<sup>22</sup> Nesip Kaçi “Si vlerësohet Ataturku në Shqipëri”, botuar në: *Ataturku dhe Ataturkizmi në këndvështrimin shqiptar*, Tiranë: Koha, 1999, f.131.

<sup>23</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), V.1923, D. 147, fl.1, Telegram Ministrisë së Punëve të Jashtme për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Tiranë, më 28 shkurt 1922.

<sup>24</sup> *AQSh*, F.151, V. 1923, D.199, 15 shkurt 1923.

<sup>25</sup> Gazmend Shpuza, *Ataturku dhe Shqiptarët*, Botim i dytë, Tiranë: Dituria, 1994, f. 41.

<sup>26</sup> *AMPJ*, F.151, V. 1922, D. 61, fl.7, Mehmet Konicë informon Kryeministrin Ypi, se: “Në Foreign Office më thanë se kanë lajme që Mustafa Qemali dërgoi ca oficerë në Shqipëri me qëllim që të ngrejë popullin në Veri e në Jug kundër Serbisë dhe Greqisë, dhe që guvernë Britanike ka besim në urtësinë e Guvernës tonë dhe që nuk beson se do të lini agentët e Qemalit ta bëjnë Shqipërinë një bazë për lëvizjen e tyre dhe të hedhin vendin tonë në zjarr... një ngjarje e tillë në

Duke marrë shkas nga propaganda aktive dhe e shumëllojshme autorët grekë kanë shkruar mbi ekzistencën e një marrëveshje të fshehtë midis Shqipërisë dhe Asamblesë së Madhe Kombëtare Turke në vitin 1922<sup>27</sup>. Përbushja e kushteve kryesore të saj do të sillte si rezultat që “Shqipëria të bëhet jo thjesht një aleate, por në një afat të gjatë, satelite e Turqisë”. Sipas tyre, marrëveshja, ishte bërë e njohur edhe në shtabin e përgjithshëm të ushtrisë greke të asaj kohe<sup>28</sup>.

cirkontantet e sotme do të konsiderohet si një akt armiqësor kundër Britanisë së Madhe e vetmja mbështetje e Shqipërisë, me një fjalë, një ngjarje e tillë do të ishte nisja e fundit të shtetit shqiptar.

<sup>27</sup> *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-V-220, Dhimitër Mihalopoulos “Përpjekje për bashkëpunim të Shqipërisë dhe Turqisë qemaliste. Marrëveshje sekrete e vitit 1922”, kumtesë e mbajtur në Kongresin V Historik Panhelen, Selanik 1964. Disa nga artikujt kryesorë të kësaj marrëveshjeje ishin: “Qeveria e Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë do të kujdesej moralisht dhe materialisht që Shqipëria të arrijë qëllimet e saja Kombëtare; Qeveria e Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë pranon që të shërbejnë në qeverinë shqiptare ushtarakët me origjinë shqiptare dhe që shërbejnë në shtetin turk ushtarak shqiptarë dhe nëpunës civilë; Qeveria shqiptare merr përsipër të përgatiti brenda vitit ose më pak, një trupë ushtrie prej 3 divizionesh; Komisioni i Mbrojtjes Kombëtare të qeverisë së Ankarasë, merr përsipër të dërgojë një mision ushtarak për stërvitjen e trupave të mësipërme; Qeveria e Shqipërisë merr përsipër që nga divizionet njëri të disponohet për kufijtë serbë, tjetri për kufijtë grekë dhe i treti për rendin dhe sigurinë e brendshme. Qeveria shqiptare detyrohet të organizojë banda dhe ti dërgojë në territorin Grek; Qeveria shqiptare detyrohet duke qenë se 2/3 e Shqipërisë përbëhen nga myslimanë, parlamenti të përbëhet 90% nga myslimanë, dhe kurrë nuk do të përdorë në ministrinë e jashtme dhe të brendshme, ministra të krishterë dhe njëkohësisht do të kujdeset të dërgojë myslimanë në vendet ku shumica janë grekë; Në asamblenë e ardhshme do të caktohet çështja e regjimit, të kihet kujdes që të sigurohet sovraniteti popullor; Në rast se nuk do të sigurohej sovraniteti popullor, procedojmë me referendum (plebishit) që të zgjidhet një primo (kryetar) Mysliman dhe për këtë duhet të bëhen përpjekjet e duhura nga ana e deputetëve myslimanë dhe të popullsisë myslimane; Qeveria shqiptare do të kujdeset që tregëtia të vijë në duar të myslimanëve dhe për këtë do të votohen ligje speciale nën këtë emër; Pasi të bëhet paqja me marrëveshje të përbashkët të dy shteteve do të caktohet komisioni i cili do të bëjë marrëveshje konsullore tregtare. (Përveç artikullit 6 të tjerat do të aplikohen pasi të bëhet paqja)”.

<sup>28</sup> *Po aty*.

Nga leximi i artikujve të marrëveshjes vihen re përkime me situatën dhe personat që e kanë nënshkruar atë<sup>29</sup>. Por rreth vërtetësisë së saj duhet të theksoj, se ka pika të errëta. Nga burimet greke, nuk sqarohen, data e saktë, mënyra sesi u përpilua, nuk kuptohet emri i kolonelit turk që nënshkroi si përfaqësues i qeverisë së Ankarasë etj. Nga ana tjetër, për palën shqiptare kjo marrëveshje nuk njihej, përderisa nuk është pranuar nga strukturat shtetërore të kohës. Ekzistenca e saj mbetet e diskutueshme, edhe për faktin se deri më sot në arkivat shqiptare dhe ato turke nuk janë gjetur ende gjurmë të kësaj marrëveshjeje por ekzistojnë vetëm komentet e bëra në shtyp<sup>30</sup>. Mendojmë se propaganda e zhvilluar rreth kësaj marrëveshjeje, lidhej edhe me situatën e paqëndrueshme politike që mbizotëroi në Shqipëri gjatë vitit 1922 si dhe me ecurinë e Luftës Greko-Turke. Ministri i Luftës, Selaudin Bej Shkoza, në Këshillin Kombëtar u akuzua nga Ahmet Zogu në këtë periudhë se kishte penguar operacionet ushtarake, si dhe për simpatinë personale qemaliste të tij. Njëkohësisht, qarkullonin fjalë se ai kishte konspiruar për të sjellë 120 oficerë nga Turqia për t'i caktuar në postet më të larta të ushtrisë shqiptare<sup>31</sup>.

Duket se ekzistenca e kësaj marrëveshjeje në kushtet kur Greqia vazhdonte të ushqente interesa për aneksimin e Shqipërisë së Jugut ishte një sajese. Fqinji jugori trembej shndërrimit të Shqipërisë në një shtet të fuqishëm si dhe rritjes së rolit Italian. I gjithë synimi i politikës së saj ishte të provonte se Shqipëria ishte e paaftë për vetëqeverisje, një vend i banuar nga myslimanë fanatikë dhe një fqinj krejt i papërshtatshëm për një shtet me një qytetërim të lashtë siç ishte vetë ajo<sup>32</sup>. Guri i themelit, thekson historiani Beqir Meta i politikës greke, ishte nxitja e dallimeve dhe pakënaqësive fetare në Shqipëri dhe theksimi i idesë se Shqipëria ishte një “Turqi e vogël”<sup>33</sup>.

<sup>29</sup> Nënshkruesit sipas kësaj marrëveshjeje ishin: Sulejman Delvina, Selaudin Shkoza dhe Jusuf Qemal Beu firmëtarit turk, personalitete të njohura politike të kohës për shtetin shqiptar dhe turk.

<sup>30</sup> G. Shpuza, *Ataturku dhe shqiptarët...*, f.41.

<sup>31</sup> Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore (1 nëntor 1918-9 nëntor 1921, statusi, kufijtë dhe rindërtimi shtetëror*, Shkodër: Camaj-Pipa, 2007, f.196.

<sup>32</sup> Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f.274.

<sup>33</sup> B. Meta, “Përpjekjet për konsolidimin...”, f.71.

### **Hapa drejt vendosjes së lidhjeve diplomatike midis dy shteteve**

Në dhjetorin e vitit 1922, me ardhjen në pushtet, të Ahmet Zogut, gjendja e shtetit shqiptar dhe interesi i tij kërkonte vendosjen e një ekuilibri në marrëdhëniet me shtetet e tjera të Ballkanit. Pozitiv ishte fakti se gjatë vitit 1922, shteti shqiptar u njoh nga një numër i konsiderueshëm shtetesh evropiane. Por fqinjët mbetën ende skeptikë karshi vendosjes së marrëdhënieve me Shqipërinë.

Më 2 janar të vitit 1923, në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar, Kryeministri i Shqipërisë, Ahmet Zogu përpos të tjerave do të shprehte dëshirën e madhe të vendit të tij, për të lidhur sa më shpejt marrëdhënie diplomatike me vendet e rajonit dhe veçanërisht me fqinjët<sup>34</sup>. Një vend të rëndësishëm zinte edhe lidhja e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Turqinë. Në këtë shtet jetonte dhe punonte një koloni shqiptare, e cila ishte e vendosur në një masë mjaft të madhe përpara 28 nëntorit 1912<sup>35</sup>, por edhe pas tij. Emigracioni i shqiptarëve në Turqi u shtua së tepërmi për shkak të shpërnguljeve masive me dhunë të popullsisë shqiptare, nga dy shtetet monarkike të fqinjëve ballkanikë, Greqia dhe Jugosllavia pas aneksimit të trevave të tyre në vitin 1913. Qeveria shqiptare, e nxitur edhe nga ndikimi i diplomacisë britanike, deri në fund të vitit 1922, nuk e njohu qeverinë e re të Mustafa Qemalit me qendër Ankaranë, madje tentoi të hynte përsëri në marrëdhënie me qeverinë e sulltanit në Stamboll. Ishte kjo arsyeja pse zyra e pasaportave në Stamboll do t'i paraqiste letrat kredenciale, në adresë të Ministrit të Punëve të Jashtme të Sulltanit<sup>36</sup>.

Konsulli i Shqipërisë në Stamboll, Nezir Leskoviku do të njoftonte qeverinë shqiptare se më 11 nëntor 1922, kabineti qeveritar i Teufik Pashës, i cili qëndronte vetëm nën fuqinë e Sulltanit dha dorëheqjen. Dorëheqja e qeverisë së Sulltanit në Stamboll, shënoi fundin e Sulltanit dhe rënien *de facto* të dinastisë otomane. Nga pikëpamja kushtetuese ky veprim tregoi që sovraniteti tanimë i përkiste popullit turk, dhe Asambleja e Madhe këtë fakt e pranoi si një element qëndrueshmërie në historinë e re të këtij shteti. Rënia e sulltanatit tregonte se Sulltanit i

<sup>34</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, viti 1923, nr.1, f.2

<sup>35</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, III, f.205.

<sup>36</sup> *AQSh*, F.151, D.98, V.1922, fl.3, Shkresë zyrës së pasaportave në Stamboll.

kishte mbetur vetëm pushteti si kryetar fetar dhe i përkohshëm,<sup>37</sup> shkak që e detyroi këtë të fundit të largohej nga Turqia<sup>38</sup>.

Qeveria shqiptare, në këtë situatë të re politike, nxitur edhe nga kërkesat e kolonisë shqiptare të Turqisë, do të kërkonte dhe do të bënte përçapjet e duhura për vendosjen e lidhjeve diplomatike me qeverinë e re turke të Ankarasë<sup>39</sup>. Konsulli shqiptar në Stamboll Nezir Leskoviku, në raportin dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri, lidhur me administratën e Stambollit do të shkruante se: “Administrata e Stambollit është kthyer në njësi të vilajetit të jashtëzakonshëm, dhe drejtues të saj janë vendosur një vali, dhe më lartë se vali një komisar i lartë prej Ankaraje. Letrat kredenciale që ishin shkruar për ministrin e Sulltanit nuk i dhashë deri sa të vijë të reja nga ana juaj”<sup>40</sup>.

Qeveria e re e Ankarasë në këtë periudhë, nuk njihte asnjë lloj marrëveshje të nënshkruar nga qeveria e Sulltanit. Në këtë kontekst natyrisht nuk njiheshin edhe funksionet legale të asnjë zyre përfaqësie të administratës së vjetër, të ngritura më parë. Këtu nuk bënte përjashtim as zyra e pasaportave e hapur në pranverë të vitit 1920, për të mbrojtur interesat e shqiptarëve që jetonin në Turqi. Përfaqësues nderi i saj ishte zgjedhur Fuad Dibra, një atdhetar shqiptar shumë i njohur dhe i respektuar në Turqi<sup>41</sup>.

Qeveria shqiptare do të shtonte përpjekjet për të hyrë në relacione me qeverinë ere turke, fillimisht për njohjen e zyrës konsullore shqiptare të ngritur në Stamboll. Më 5 janar të vitit 1923, gjatë një takimi me komisionerin e Stambollit Adnan Beun [Adivari], Nezir Leskoviku do t'i

---

<sup>37</sup> *Po aty*, F.251, d.98, f.1922, fl.1-3, Raport dërguar ministrit të Punëve të Jashtme Pandeli Evangjelit nga konsulli i Stambollit, Nezir Leskoviku, më 11 nëntor 1922.

<sup>38</sup> *Po aty*, F. 251, D.98, V.1922, fl.4, Njoftim nga konsullata e Stambollit për ministrin e Punëve të Jashtme Pandeli Evangjeli, dt.18 nëntor 1922.

<sup>39</sup> *Po aty*, F. 151, V. 1922, D. 98, dt.18 nëntor. Nezir Leskoviku, përgjegjës i zyrës së pasaportave në Stamboll, u takua jo zyrtarisht me valiun dhe me komisarin e Stambollit. Në njoftimin dërguar ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, ai bënte me dije se Refat Pasha i kishte deklaruar: “Konvensionet e bame në kohën e administratës së parë nuk i njohim, por këto që më thatë do t’ia komunikoj Angoras (Ankarasë) dhe përgjigjen që do ta marr do t’iu bëj të ditur. Megjithëkëtë me Shqipërinë s’ka dyshim se do të merremi vesh më parë dhe më shpejt”.

<sup>40</sup> *Po aty*, F.151, V.1922, D.98, fl.1-3, dt.18 nëntor 1922, vazhdim i raportit të datës 11 nëntor 1922.

<sup>41</sup> *AMPJ*, V. 1922, D. 4. Mbi dekretimin e disa personaliteteve.

parashtronte edhe njëherë problemin e zyrës së pasaportave shqiptare. Adnan Beu, nga ana e tij në lidhje me problemin që ngrinte pala shqiptare do të kërkonte instruksione nga Ankaraja, në lidhje me çështjen e zyrës shqiptare të pasaportave në Stamboll dhe kthimit të saj në zyrë konsullore<sup>42</sup>.

Një muaj më pas, në shkurt të vitit 1923, midis Nezir Leskovikut dhe Adnan Beut do të realizohej një takim i dytë. Në këtë takim, Adnan Beu do t'i shpjegonte përfaqësuesit të Shqipërisë, se sipas Ankarasë për të kërkuar hapjen e zyrës “duhet të kishte një letër besimi në dorë dhe sa për çështjen e hapjes së konsullatës duhej të përcaktohej qartë nëse marrëveshja që kërkohej do të ishte konsullore apo diplomatike”<sup>43</sup>. Përfaqësuesi shqiptar do të sqaronte se “marrëveshjet e shkruara më parë ishin konsullore dhe jo diplomatike, dhe se për të provuar kompetencat e tija, dokumentet që dispononte ishin të mjaftueshme”. Më 21 prill 1923, në një letër dërguar qeverisë shqiptare nga ana e komisionit turk të ngarkuar për lidhjet e marrëveshjeve diplomatike theksohej se: “Qeveria e Ankarasë ishte e gatshme të hynte në bisedime për një marrëveshje, por duhet që delegati i Shqipërisë në Lozanë t'i drejtohet drejtpërsëdrejti, Ismet Pashës [Inonysë] në cilësinë e ministrit të Jashtëm”<sup>44</sup>. Prandaj Ministria e Jashtme ngarkoi konsullin shqiptar në Gjenevë, Benoit Blinishtin që të takonte Ismet Pashën. Në këtë takim Ismet Pasha i premtoi Benoit Blinishtit se do t'i rekomandonte qeverisë së tij, njohjen zyrtare të konsullit shqiptar<sup>45</sup>.

Në raportin dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Benoit Blinishti informonte se Ismet Pasha, pavarësisht se dëshironte të lidhej marrëveshja i kishte lënë pezull disa gjëra. Në këtë përfundim, ai kishte dalë pas takimit, të zhvilluar edhe me një delegat tjetër turk në konferencë. Ky personalitet, kishte lënë të kuptohej që Ankaraja donte të realizonte një marrëveshje me Shqipërinë, por problem vazhdonte të mbetej çështja e nacionalitetit të shqiptarëve që jetonin në Turqi. Qeveria turke do ta zgjidhte këtë problem, siç kishte bërë me sirianët, të cilët nëse

<sup>42</sup> *AQSh*, F. 151, V.1923, D.199, Letër drejtuar P.Evangjelit, ministër i Punëve të Jashtme, më 21 shkurt 1923.

<sup>43</sup> *Po aty*.

<sup>44</sup> *Po aty*, F.151, V.1923, D.199, nr.144, Relacion për ministrin e Punëve të Jashtme, Pandeli Evangjeli.

<sup>45</sup> *AMPJ*, V.1922, D. 98, fl.3, Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme mbi relacionet zyrtare shqiptaro-turke, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

do të vendosnin të banonin në Turqi do të konsideroheshin të gjithë shtetas turq. Po ky personalitet e këshillonte Benoit Blinishtin që delegacioni shqiptar të dërgojë një letër në Ankara, në mënyrë që të merren vesh lidhur me këto çështje, si edhe të njoftohet mendimi i palës shqiptare lidhur me shqiptarët që banojnë në Turqi.<sup>46</sup> Nisur nga rrethanat e krijuara, Benoit Blinishti i sugjeronte ministrit të Jashtëm, Pandeli Evangjelit se duhej të dërgonte një delegacion në Ankara, për zgjidhjen e këtij problemi dhe të kërkonte hapjen e një përfaqësie diplomatike pranë qeverisë turke<sup>47</sup>.

Qeveria shqiptare bazuar dhe në të drejtën ndërkombëtare do të jepte mendimin e saj në lidhje me tezën e shtetësisë të hedhur nga ana e turqve. Ajo theksonte se: “pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore në marrëveshjet që u bënë midis shteteve të ndryshme, shtetasit e huaj banues në këto vende u lanë të lirë të marrin nënshtetësinë e qeverisë tjetër, pra edhe shqiptarët duhet që të përfitojnë nga ky rregull ndërkombëtar, në mënyrë që të ruajnë shtetësinë e vendlindjes së tyre, atë shqiptare”<sup>48</sup>.

Diskutimet lidhur me këtë çështje do të gjenin pasqyrim edhe në shtypin e kohës. Gazeta turke “Vatan” (Atdheu) theksonte se: “pasi u pyet komisioni qeveritar për punët e brendshme, nga ana e tij u deklarua se të gjithë shqiptarët që banonin në Turqi, apo erdhën kur u krijua shteti shqiptar dhe jo vetëm gjatë luftës numërohen si nënshtetas turq. Ndërsa ata që erdhën nga vendi i tyre të pajisur me pasaportë ose me certifikatë apo shkresa të tjera të lëshuara nga qeveria shqiptare numërohen si nënshtetas shqiptarë”<sup>49</sup>. Disa gazeta të tjera turke, do të komentonin se njihen si nënshtetas shqiptarë nga qeveria e re turke, vetëm ata që shkojnë e vijnë nga Shqipëria për tregti dhe jo të tjerët, që janë vendosur më parë dhe janë me banim në Turqi<sup>50</sup>. Gazeta “Ileri”(Përpara)do të shkruante se

<sup>46</sup> *AQSh*, F. 151, V.1923, D. 199, Mbi delegacionet shqiptaro-turke.

<sup>47</sup> *AMPJ*, D.98, V.1992, fl.17-18. Letër e konsullit shqiptar në Gjenevë, Benoit Blinishti për ministrin e Punëve të Jashtëm, Pandeli Evangjeli, më dt. 5.5.1923.

<sup>48</sup> *AQSh*, F.151, V.1923, D. 199, Shkresë zyrtare nr.10321, Ministria e Punëve të Brendshme i kthen përgjigje Ministrisë së Punëve të Jashtëm.

<sup>49</sup> *Shqipëria e re*, Kostancë, 12 qershor 1923, nr. 135, f.2.

<sup>50</sup> *AQSh*, F. 151, V. 1923, D. 199, nr.151, 18 maj, Raport mbi situatën e konsullatës në Stamboll.

“shkaku që deri më sot nuk janë bërë ende marrëveshje politike e miqësore ndërmjet Turqisë e Shqipërisë, ishte ai i nënshtetësisë”<sup>51</sup>.

Pavarësisht problemeve, vendosja e marrëdhënieve diplomatike konsiderohej e rëndësishme për të dy vendet. Në qershor të vitit 1923, Nezir Leskoviku përfaqësuesi shqiptar i Stambollit do të jepte një intervistë në lidhje me relacionet midis Shqipërisë dhe Turqisë duke deklaruar se “me qeverinë osmane kishin patur relacione zyrtare, por me qeverinë e re po bënin përpjekje që të arriheshin ato”<sup>52</sup>. Ndërkohë në Asamblenë Kombëtare Turke u ngrit një komision, prej dhjetë anëtarësh, i kryesuar nga deputeti Xhevat Abaz, të cilët morën nismën për të filluar negociatat për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Ata kishin arritur në Itali dhe po përpiqeshin të vinin në Shqipëri që të merreshin me këtë çështje<sup>53</sup>.

Edhe shqiptarët filluan të bënin përçapje të reja për të hyrë në marrëdhënie me qeverinë e Ankarasë. Në qershor 1923, Ali Kolonja përfaqësuesi i Shqipërisë në Beograd, do të takonte Xhevat Beun, përfaqësuesin e qeverisë turke në kryeqytetin jugosllav duke i shprehur dëshirën e qeverisë shqiptare për të hyrë në marrëdhënie diplomatike me qeverinë e Ankarasë. Kjo ishte prituri mirë nga përfaqësuesi turk, i cili ishte shprehur pozitivisht dhe kishte vlerësuar politikën e qeverisë shqiptare, duke shtuar se një gjë të tillë e dëshironte edhe qeveria e tij. Më tej ai do të deklaronte se kishte besim të plotë në përfaqësinë e kryeministrit shqiptar dhe në zotësinë e qeverisë së pavarur<sup>54</sup>. Pak ditë më vonë gazeta “Shqipëria e re” botoi lajmin se “qeveria turke e ftonte qeverinë shqiptare të dërgonte përfaqësuesit e saj në Ankara për të bërë një marrëveshje konsullore midis të dyja shteteve”<sup>55</sup>.

Kryeministri Ahmet Zogu, në një letër drejtuar Nezir Leskovikut, do t’i kërkonte këtij të fundit të bënte demarshe pranë Adnan Beut valiut të Stambollit, për pranimin e një delegacioni shqiptar në Ankara. Ai theksonte se: “Qeveria shqiptare i jep një rëndësi të madhe lidhjes së

<sup>51</sup> *Shqipëria e re*, 12 qershor 1923, nr.135, f.2, art. “Shqip në Turqi”.

<sup>52</sup> *Po aty*, 12 qershor 1923, nr.35, f.2, art. “Letër nga Stambolli”; *po aty*, art. “Intervistë me zotin konsull”.

<sup>53</sup> *AMPJ*, F. 151, V.1922, D. 57, Tel. nr. 211, Njoftim i prefekturës të Shkodrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

<sup>54</sup> *AQSh*, F.251, V.1923, D.199, fl.23, Shkresë e MPJ drejtuar MPB, Tiranë, 19 qershor 1923.

<sup>55</sup> *Shqipëria e re*, dt. 24 qershor 1923, f.4, art. “Turqia dhe Shqipëria”.

marrëdhënieve me Turqinë dhe do të jetë e lumtur në qoftë se do të marrë përgjigje të favorshme nga ana e qeverisë turke”<sup>56</sup>. Nezir Leskoviku disa ditë më vonë në raportin dërguar Kryeministrit shqiptar, informonte se në takimin me Adnan Beun, kishte deklaruar që “Shqipëria prej kohe ka dashur të përfundohet çështja e marrëveshjes, gjithnjë me ndërmjetësinë tuaj por mjerisht nuk mundim të kuptojmë, pse Ankaraja deri më sot asht dftueme kaq indiferente”<sup>57</sup>.

Duket qartë se Turqia në këtë kohë, krahas përgatitjeve për ndryshimin e sistemit dhe vendosjes së stabilitetit në vend, ishte e zënë me çështjen e shkëmbimit të popullsisë dhe formimit të një shteti homogjen turk pa elementë të huaj. Në këndvështrimin e saj, ajo nuk e shihte ende të favorshme kohën për të lidhur marrëdhënie me Shqipërinë. Por disa muaj më vonë më 5 tetor 1923 në pragun e shpalljes së Republikës Ismet Pasha, ministri i Jashtëm i qeverisë së Asamblesë së Madhe Turke do t’i dërgonte një telegram qeverisë shqiptare. Me anën e tij, e ftonte atë të dërgonte një delegacion në Ankara, për t’u marrë vesh me qeverinë e tij, në mënyrë që të fillonin bisedimet për lidhjen e marrëdhënieve midis dy vendeve<sup>58</sup>. Kjo do të shënonte edhe kalimin drejt fazës së vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve.

### **Vendosja e marrëdhënieve diplomatike**

Më 9 tetor 1923, qeveria shqiptare, caktoi një delegacion i cili u nis për në Ankara me ftesën e qeverisë turke<sup>59</sup>. Në përbërje të tij ishin Eshref Frashëri, kryetar i Parlamentit, Xhafer Vila, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë dhe Nezir Leskoviku, përfaqësues i dërgatës shqiptare në Stamboll<sup>60</sup>. Më 17 tetor 1923, delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Eshref Frashëri arriti në Stamboll. Delegacioni shqiptar u prit miqësisht nga autoritetet vendore dhe kolonia

---

<sup>56</sup> *AQSh*, F.151, V.1923, D.199, Letër drejtuar Nezir Leskovikut konsullit të Stambollit, dt. 9 gusht 1923.

<sup>57</sup> *Po aty*, F.151, V.1923, D.199, nr.173, Mbi intervistën me Adnan Beun. Raport për kryeministrin Ahmet Zogu.

<sup>58</sup> *Po aty*, F.151, V.1923, D. 200, Telegram i Ismet Pashës për ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

<sup>59</sup> *Tanin*, 18 tetor 1927, s.1.

<sup>60</sup> *AQSh*, F.151, V.1923, D. 200, fl.15, Artikull marrë nga gazeta “Politia”.

e shqiptarëve të Stambollit. Të nesërmen ai u nis për në Ankara<sup>61</sup>. Takimin e parë delegacioni e zhvilloi me Kryeministrin e qeverisë turke Fethi Bej Okjarin, të cilit iu bë e ditur dëshira e qeverisë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve shqiptaro-turke<sup>62</sup>.

Ndërkohë që delegacioni shqiptar bënte takime, një zhvillim i rëndësishëm ndodhi për Turqinë. Më 29 tetor 1923, ajo u shpall Republikë dhe president i parë i saj në mënyrë unanime u zgjodh Mustafa Qemali<sup>63</sup>. Nga pikëpamja juridike duhet të theksojmë se shndërrimi i një rendi gjysëm teokratik në një sistem të ri republikan përbënte një ndryshim të madh në natyrën e shtetit. Shpallja e Republikës së Turqisë u prit pozitivisht nga vende të ndryshme, po ashtu edhe nga Shqipëria. Më 31 tetor 1923, Ahmet Zogu në postin e kryeministrit të qeverisë shqiptare, i dërgoi një telegram urimi kryeministrit turk Fethi Bej Okyarit. Ai shprehte urimet për shpalljen e Republikës Turke dhe vlerësonte lart zgjedhjen e Mustafa Qemalit në postin e presidentit të parë të saj.<sup>64</sup>

Më 1 nëntor 1923, gazeta “Dielli”, botonte lajmin se qeveria e Fethi Beut kishte dhënë dorëheqjen. Kryetari i Republikës Turke, Mustafa Qemali, tashmë kishte ngarkuar Ismet Pashë Inonynë të formonte një kabinet të ri. Ismet Inony krahas drejtimit të qeverisë, mbajti edhe postin e ministrit të Jashtëm<sup>65</sup>. Në javën e parë të nëntorit delegacioni shqiptar ishte pritur me nderime edhe nga Ismet Pasha tashmë ministër i Jashtëm i Turqisë, i cili do të siguronte palën shqiptare se interesat e Turqisë kërkonin që Shqipëria të konsolidohej dhe të forcohej në Ballkan<sup>66</sup>. Pas këtyre takimeve të para delegacionit shqiptar, ju desh të priste edhe tri javë që të fillonin bisedimet, sepse duhej të respektoheshin rregullat e protokollit të shtetit turk për përfundimin e formaliteteve zyrtare.

Më 13 nëntor 1923, gazeta turke “Vakit” (Koha) njoftonte nisjen e bisedimeve shqiptaro-turke. Nga pala turke përfaqësues do të caktohej

<sup>61</sup> *AQSh*, F.151, V. 1923, D. 200, fl. 8, Telegram drejtuar MPJ, Stamboll, 17 tetor 1923.

<sup>62</sup> *Po aty*, fl.36, Telegram drejtuar MPJ nga Ankaraja.

<sup>63</sup> *Po aty*, fl.11, Telegram drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ankara, 30 tetor 1923.

<sup>64</sup> Bilal N. Simsir, *Atatürk ve Yabancı DevletBaşkanlari*, dok.no.368, Türkiye Tarih Kurumu Ankara: 1981, s.28.

<sup>65</sup> *Dielli*, nr. 26345 (177), 1 nëntor 1923.

<sup>66</sup> *AQSh*, F. 151, D.200, fl. 34. Tel. drejtuar MPJ, Ankara, 7 nëntor 1923.

Shykri Kaja Beu i cili mbante postin e ministrit të Brendshëm si dhe të zëvendësministrit të Punëve të Jashtme. Krahas tij anëtarë të delegacionit turk u caktuan edhe dy këshilltarë juridik, Nusret dhe Refik Beu<sup>67</sup>.

Nga pala shqiptare në takim vazhdonin të ishin përfaqësues Eshref Frashëri, Xhafer Bej Vila dhe Nezir Leskoviku<sup>68</sup>. Në fjalën e hapjes, Shykri Kaja Beu vuri në dukje “traditat e vjetra të miqësisë që lidhnin popullin shqiptar me popullin turk duke theksuar dëshirën e qeverisë turke për një Shqipëri të zonjën dhe për një jetë të pavarur politike”. Fillimisht pala turke propozoi të lidhej një traktat miqësie, praktikë të cilën qeveria turke e kishte aplikuar në parim me të gjithë qeveritë që kishin lidhur marrëdhënie diplomatike me të. Si model përdorej traktati turko-polak, i firmosur disa kohë më parë.<sup>69</sup>

Delegacioni shqiptar do të deklaronte se detyra e të dyjave palëve në këto bisedime ishte që të fiksonin në letër miqësinë që ekzistonte prej kohësh midis të dy popujve dhe shprehte ndërkohë gëzimin që traktatin e parë të miqësisë shteti shqiptar po e lidhte me vëllezërit turq. Eshref Frashëri do të vinte në dukje gjithashtu edhe traditat më të reja revolucionare të popullit shqiptar por edhe të popullit turk, luftërat e tyre për liri në mbarim dhe pas Luftës së Parë Botërore etj. Më tej ai do ta vinte theksin, në interesat e përbashkëta shqiptaro-turke, duke deklaruar se të dyja vendet për shpëtimin e tyre qenë mbështetur në forcat e veta dhe ekzistencën e tyre ia dedikonin pikërisht këtyre forcave<sup>70</sup>.

Në përgjigje të fjalës së Shykri Kaja Beut dhe në përforsim të deklaratave të përfaqësuesit shqiptarë, gazeta e kolonisë shqiptare “Barış” (Paqja), që dilte në Stamboll, deklaronte: “se nuk janë vetëm jeta e gjatë që kanë shkuar bashkë të dy këta kombe, relacionet familjare që i kanë lidhur, interesat financiare dhe tregtare që i kanë afruar, por janë dhe shumë gjëra të tjera që mjaftojnë ta shtojnë këtë miqësi dhe besim ndërmjet të dy kombeve... Turqia vetëm me ndihmën e bijve të saj

<sup>67</sup> *Başbakanlık Cumhuriyet Arşivine* (më tej: BCA) 1923, fon kodu: 030181, yer no.1/8.39.3

<sup>68</sup> Kryetar i delegacionit ishte Eshref Frashëri në këtë kohë, kryetar i Parlamentit Shqiptar. Po ashtu edhe Xhafer Bej Vila, ishte sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Nezir Leskoviku përfaqësuesi i qeverisë shqiptare në Stamboll.

<sup>69</sup> *TBMM Kavanin Mecmuasi*, devre: II, cilt 3, ictimai:2, ikinci baski 1942, Ankara, s.131-137.

<sup>70</sup> *Vakit gazetesine*, 19 kasim 1923, “*Türk-Arnavutluk münasebati*”.

besnikë drejt një ideje kombëtare fitoi lirim të viseve të shenjta nga shkelmi i të huajve, gjithashtu edhe Shqipëria e vogël me ndihmën vetëm të bijve të saj liroi vendin nga okupacionet e armiqëve...<sup>71</sup>

Më 15 dhjetor të vitit 1923 në Ankara, pas bisedimesh që zgjatën gati 3 muaj u firmosën tre marrëveshje që njihen me emrin “*Traktati i Miqësisë*”<sup>72</sup>. Ato ishin: marrëveshja e vendosjes së marrëdhënies diplomatike, marrëveshja e banimit dhe marrëveshja e nënshtetësisë.

Një analizë e përmbajtjes të këtij traktati na duket i përligjur për të hedhur dritë mbi rëndësinë dhe rrjedhojat e tij në marrëdhëniet midis dy vendeve. Që në aktin e tij të parë i jepej rëndësi vendosjes së lidhjeve diplomatike midis dy popujve dhe konfirmohej se: “midis Republikës së Turqisë dhe shtetit shqiptar dhe sidomos në mes të nënshtetasve të të dyja vendeve do të ekzistojë një miqësi e përvetshme, që nuk do të priset kurrë”. Në aktet pasuese gjithashtu do të theksohej se të dy qeveritë do të vendosnin marrëdhënie diplomatike mbi bazën e të drejtave ndërkombëtare dhe se përfaqësuesit e tyre konsullor gëzonin të drejta dhe nderime të ndërsjella. Pasi traktati të shkëmbehej, duhet të kalonin 15 ditë që të hynte në veprim. Këtë traktat e nënshkruan dhe e vulosën delegatët e të dyja palëve<sup>73</sup>.

Në pjesën e dytë të traktatit e rëndësishme, ishte nënshkrimi i Konventës së Banimit midis dy vendeve, në të cilën parashikoheshin të drejtat dhe detyrat e nënshtetasve shqiptarë dhe turq në vendet e njëritjetrit. Kjo marrëveshje përbëhej nga dhjetë pika<sup>74</sup>. Ndërsa në pjesën e

<sup>71</sup> *Bariş gazetesine*, Istanbul, 17 Aralık 1923, “*Türkiye ve Arnavutluk*”.

<sup>72</sup> *BCA*, 1171/73-19: Türkiye Cumhuriyeti ile Arnavutluk Hükümetleri arasındaki Tabiyet anlaşmasının üçüncü ve dördüncü maddeleri Bakanlar Kurulu'nun 9 Haziran 1926 tarihli toplantısında düzenlendi. *BCA*, 3079/ 421-52. Ky traktat u botua në: *Gazeta e Korçës*, dt.12.1.1924, art. “Traktatet turko-shqiptare”; *Dielli*, dt. 9. 2, 1924, “Lajmi Traktatit midis Shqipërisë dhe Turqisë”; shih edhe N.P. Alpan, *Tarihin ışıında Arnavutluk*, Ankara, f.96; shih edhe A. Gündüz Okçün, *Türkiyenin Taraf Olduğu Milletlerarası Andlaşmalar (1920-1961)*, Rehberi, Dogus LTd, Sirketi, Matb. Ankara: 1962, f.35-43; shih edhe Utkan Kocaturk, *Atatürk ve Türkiye Cumhuriyeti tarihi kronolojisi 1918-1938*, TTK Basımevi, Ankara: 2000, f. 405.

<sup>73</sup> *Bariş*, Stamboll, nr.5, dt. 11 dhjetor 1923.

<sup>74</sup> *AMPJ*, D.38, V.1925, fl.1-8: *Traktat Miqësisë. Konvente vendosjeje ne mjes te Shqipnis e te Tyrqis*: Art 1. Nënshtetasit e të dy anëve kontraktuese do të kenë të drejtë të rrinë e të qëndrojnë në tokën e tjetrit, duke lëvizur të lirë konform ligjeve të dy vendeve. Art.2.Në dispozitat e kësaj Konvente nuk hyn çështja e emigracionit

tretë të traktatit rëndësi kishte nënshkrimi i marrëveshjes së nënshtetësisë e cila përbëhej nga shtatë artikuj<sup>75</sup>.

Përsa i takon bisedimeve lidhur me çështjen e nënshtetësisë, nga të dyja palët u paraqitën pikëpamje të ndryshme. Delegacioni shqiptar nga ana e tij kërkoi që, shqiptarët nga territoret e përfshira në shtetin shqiptar, por me banim në Turqi, të quheshin nënshtetas shqiptarë, ndërsa shqiptarët nga trojet shqiptare të shkëputura me Traktatin e Berlinit a të Londrës të kishin të drejtën e zgjedhjes (droit d'option)<sup>76</sup>. Mirëpo edhe ky propozim nuk u pranua nga pala turke dhe me këto kushte delegacioni shqiptar do të detyrohej të dilte me një propozim të dytë. U kërkua njohja e nënshtetësisë shqiptare për shqiptarët që kanë shkuar në Turqi pas Luftërave Ballkanike dhe e drejta e zgjedhjes për shqiptarët që banojnë në Turqi qysh nga kohët e vjetra<sup>77</sup>. Nga ana e tij, delegacioni turk, nisur nga principet e tija, në bazë të së drejtës ndërkombëtare quante nënshtetas turq të gjithë personat me origjinë nga viset e braktisura nga Perandoria Osmane, por që banonin në Turqi. Mbi këtë bazë ai do të shprehej për dhënien e të drejtës së zgjedhjes (droit d'option), vetëm për shqiptarët që kishin ardhur në Turqi pas Luftërave Ballkanike. Qëndrimin e vet në këtë çështje pala turke e mbështeste në traktatet e lidhura me shtetet e tjera, të cilave, siç është përmendur nuk u ishte njohur e drejta e zgjedhjes. Ajo shtoi se nëse Turqia do t'i jepte shqiptarëve ndonjë të drejtë më tepër, atëherë bashkë me ta do të përfitonin edhe nacionalitetet e tjera, si: arabët, sirianët dhe egjiptianët që banonin në Turqi<sup>78</sup>.

Pala shqiptare nga ana e saj u përpoq të dilte me një propozim të fundit, me anën e të cilit kërkonte që shqiptarët e ardhur nga trevat që i kishin mbetur Shqipërisë, duhet të kishin mundësinë e zgjedhjes brenda

---

...Art. 3. Nënshtetasit e të dy anëvet kontraktuese kanë për të pasur në tokën e tjetrit të drejtën me ekzistues ç' do lloj industrit e tregtije si dhe m'u marrun me të gjitha zanatet e profesionet, përveç atyre që janë të rezervueme për qytetarët si mbas ligjeve e rregullave përkatëse...etj.

<sup>75</sup> Halil Ozcan, *Atatürk Dönemi Türkiye-Arnavutluk ilişkileri (1920-1938)*, Ankara: AKDITYK Atatürk Araştırma Merkezi, 2011, f.135.

<sup>76</sup> *AQSh*, F.151, V.1923, D.200, fl.56-58, Konstantinopojë, 29 nëntor 1923.

<sup>77</sup> *Po aty*, fl.56-58. "Lidhur me shqiptarët e Kosovës nuk u formulua ndonjë propozim i ri, i raportonte Tiranës, Eshref Frashëri kryetari i delegacionit shqiptar, se delegata turke për këtë çështje nuk desh të hynte fare në bisedime, duke thënë se kjo çështje i takon Serbisë".

<sup>78</sup> *Hakimiyet-i Milliye*, 21 nëntor 1923, s.1-3.

një afati tre vjeçar. Gjatë kësaj kohe shqiptarët të mos merreshin ushtarë dhe ata që do të zgjidhnin nënshtetësinë shqiptare në qoftë se gjatë kësaj kohe ende nuk kishin mundur të likuidonin pasuritë e tyre dhe do të largoheshin nga Turqia, të kishin të drejtën që t'i administronin ato me anë të përfaqësuesve të tyre. Edhe ky kompromis nxiti debate, sepse pala turke nuk qe dakord lidhur me lirin e kësaj kategorie nga detyrimi ushtarak. Udhëzimet e marra nga qeveria shqiptare nuk i jepnin të drejtë delegacionit të saj të bënte lëshime të mëtejshme, prandaj edhe në këto kushte bisedimet u ndërpre<sup>79</sup>.

Më 1 dhjetor 1923, në Stamboll, delegacioni shqiptar synoi sërish kompromisin, duke ofruar një propozim tjetër sipas të cilit shqiptarët të cilët mbushin moshën e ushtrisë duhet ta ushtronin menjëherë të drejtën e zgjedhjes. Ata që do të deklarorin nënshtetësinë shqiptare të ktheheshin menjëherë në Shqipëri, ndërsa ata që do të vendosnin për të qëndruar në Turqi, të merreshin në shërbimin ushtarak nga autoritetet turke<sup>80</sup>.

Pas këtij takimi bisedimet u ndërpre. Komente të ndryshme do të bëheshin në shtyp. Gazeta "*Hakimiyet-i Milliye*", do ta shikonte ndërprerjen e bisedimeve si një hapësirë kohe dhe se lidhur me to çdo palë mori liri veprimi<sup>81</sup>. Kjo linte të nënkuptohej që edhe pikat për të cilat ishte arritur në të njëjtin arsyetim dhe mendim të përbashkët nuk qëndronin më dhe për rrjedhojë nuk do të njiheshin. Nga ana e tij, Shykry Kaja Beu do të linte të kuptohej se bisedimet do të fillonin përsëri nga e para dhe jo nga aty ku ishin lënë dhe se nuk bëhej fjalë për ndërprerje të bisedimeve, por për një shtyrje të re të tyre, dhe faktikisht kështu ndodhi<sup>82</sup>. Më pas ai do të shtonte se, të dyja palët ishin të interesuara për vendosjen e marrëdhënieve, por në karakterizimin e motiveve që i shtynin drejt vendosjes së tyre ai do të tregohej i njëanshëm. "Në duhet njeriu të thotë të drejtën, - shtonte ai po aty, le të themi se interesa jonë është morale dhe e shqiptarëve materiale"<sup>83</sup>.

Interesimi i delegacionit shqiptar për shqiptarët që jetonin jashtë Shqipërisë në të vërtetë nuk kishte të bënte thjesht me interesa materiale, por para së gjithash me interesa kombëtare, sepse më shumë se gjysma e kombit ndodhej jashtë trojeve etnike. Mosmarrëveshjet në fushën e

<sup>79</sup> *Vakit gazetesi*, 29 nëntor 1923; *Bariş gazetesi*, Istanbul nr.3, 26 nëntor 1923.

<sup>80</sup> *Paaja*, dt. 26 nëntor 1923, nr.3.

<sup>81</sup> *Hakimiyet-i Milliye*, dt.19 nëntor 1923.

<sup>82</sup> *Vakit gazetesi*, 23 kasim 1923.

<sup>83</sup> *Po aty*.

nënshtetësisë e detyruan atë që në dobi të interesave të vendit të tërhiqej nga propozimet dhe kundërpropozimet, madje edhe nga kompromiset që u paraqitën. Kjo duket mjaft qartë po të shihet teksti përfundimtar i marrëveshjes së nënshtetësisë<sup>84</sup>. Tërheqja e palës shqiptare pas udhëzimeve të ardhura nga Tirana, do të ndikonte në përfundimin e shpejtë të marrëveshjes për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, të marrëveshjes konsullore dhe të asaj të nënshtetësisë. Marrëveshjet u nënshkruan në ish-Ministrinë e Punëve të Jashtme në Stamboll, në dy kopje në frëngjisht dhe në dy kopje turqisht<sup>85</sup>. Ismet Pasha në postin e kryeministrit të qeverisë turke, do të uronte telegrafisht përfaqësuesin shqiptar për përfundimin e marrëveshjeve, duke shprehur bindjen që lidhja e marrëdhënieve të miqësisë do të shërbente në të ardhmen për forcimin e lidhjeve midis dy kombeve<sup>86</sup>. Telegrami urimi u shkëmbyen edhe midis Ismet Pashës dhe kryeministrit të asaj kohe, Ahmet Zogu<sup>87</sup>.

Marrëveshjet e nënshkruara mes dy shteteve nuk u zbatuan menjëherë, shkaku kryesor duhet të kërkohet tek situata politike në të dy vendet, por edhe tek mosratifikimi i “Traktatit të Miqësisë” të dhjetorit 1923, nga parlamentet e Turqisë dhe Shqipërisë. Ngjarjet e vitit 1924 në Shqipëri, si dhe qëndrimi i Ataturkut për çështjen shqiptare e shtynë lidhjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve<sup>88</sup>.

Në mars të vitit 1924, në Turqi u ndërmor një reformë e rëndësishme, u rrëzua Kalifati<sup>89</sup>. Rrëzimi i tij ishte një nga reformat më të thella e radikale të ndërmara nga Mustafa Qemali me ndikim të rëndësishëm në ecurinë e mëtejshme të shtetit turk<sup>90</sup>. Reforma shkaktoi një krizë të re qeveritare e cila solli në pushtet kabinetin e ri të Fethi Bej Okyari<sup>91</sup>. Ndryshimin e qeverisë në Turqi, do ta përshëndeste edhe

<sup>84</sup> *Shqiptari i Amerikës*, nr.70, 12 janar 1924. Ky tekst u mor nga gazeta *Paqja* që botohej në Stamboll.

<sup>85</sup> *Akşam gazetesi*, dt. 9 dhjetor 1923.

<sup>86</sup> *AQSh*, F.151, V.1923, D. 200, fl.65, Telegrami i Ismet Pashës, Ankara, 8 dhjetor.

<sup>87</sup> *Po aty*, F.70, V. 1923, D. 200, fl.65, Telegrami i Ismet Pashës, Ankara, 23 dhjetor.

<sup>88</sup> Shyqyri Hysi, *Rauf Fico-shtetar dhe diplomat i shquar*, Tiranë: Mësonjëtorja, 2007, f.85.

<sup>89</sup> *Hak*, Stamboll, dt. 2 prill 1924.

<sup>90</sup> “Gjendja në Turqi”, në: *Gazeta e Korçës*, 18 nëntor 1924, nr.143, f.1.

<sup>91</sup> “Kriza në Turqi”, *po aty*, 29 nëntor 1924, nr.147, f.1.

qeveria e re shqiptare ajo e Fan Nolit. Në telegramin e urimit, ajo do të shprehte qëllimin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike<sup>92</sup>. Nuk ka të dhëna sesi reagoi qeveria e Ankarasë ndaj ndryshimeve politike që ndodhën në Shqipëri, por mund të thuhet se, gjatë kohës që ishte në pushtet qeveria e Fan S. Nolit, marrëdhëniet midis dy shteteve ishin të ngrira.

Vetëm më 30 nëntor 1924, “Traktati i Miqësisë” dhe ligjet e shkruara në brendësi të tij u pranuan në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe u ratifikuan në shkurt 1925<sup>93</sup>, pas zgjedhjes së Ahmet Zogut, si President të Republikës. Ahmet Zogu do t’i vlerësonte dhe çmonte marrëveshjet e nisura që në vitin 1923, në kohën kur ai ishte kryeministër dhe më 1 shkurt të vitit 1925, pas ratifikimit nga Asambleja Legjislative, do ta dekretonte “Traktatin e Miqësisë” të lidhur midis dy popujve. Nga Asambleja e Madhe Kombëtare Turke ky traktat u ratifikua më 6 prill 1925<sup>94</sup>.

Me rastin e hyrjes në fuqi të “Traktatit të Miqësisë” nga ana e palës turke, Ahmet Zogu më 19 prill 1925, i dërgoi Mustafa Qemalit një letër miqësore. Në letër Zogu do të shkruante: “Në Ankara pra brenda Republikës tuaj, është formuar një grup i përbërë nga parlamentarë që do të ndjekin vazhdimësinë e marrëdhënieve sipas protokollit të firmosur nga të dy palët me anë të cilit u rivendos miqësia dhe dashamirësia mes dy popujve tanë.... Lidhjet e përsosura të përbashkëta mes popujve tanë në të shkuarën kanë vërtetuar miqësinë tonë dhe shpresoj që me anë të këtyre marrëveshjeve në historinë e të ardhmes të shkruhet për miqësi e paqe”<sup>95</sup>.

<sup>92</sup> *AQSH*, F. 151, V. 1924, D.300, Koncept telegrami i Fan S.Nolit (shkruar nga ai) dhe Luigj Gurakuqit drejtuar Fethi Beut.

<sup>93</sup> Ratifikimi i marrëveshjes sipas arkivave shqiptare u bë më 22 shkurt nga Parlamenti Shqiptar dhe firmosja më 3 mars 1925 nga Presidenti shqiptar. Për më tepër shih: *AQSh*, F.151, V.1925, D.123, Mbi këtë fakt të njëjtat të dhëna jep edhe arkiva turke për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje; *BCA*, 1171/73-19; Shih edhe Hikmet Oksüz, *Atatürk dönemi Türk-Arnavut ilişkileri*, in: *Güney Doğu Avrupa Araştırmaları Dergisi*, Istanbul 1998, no. 12, f.211

<sup>94</sup> *AQSh*, F.151, V.1925, D.22, fl.1, Tel. nga Pera, 7 prill 1925; Shih edhe: A.Gündüz Ökçün, *Türkiye'nin Taraf olduğu Milletlerarası Andlaşmalar Rehberi (1920-1961)*, Doğu Ltd, Sirketi, Matb. Ankara, 1962, f.35-43.

<sup>95</sup> Bilal N. Simşir, *Atatürk ve yabancı Devlet Başkanları*, v.1, Stamboll: 1993, f.284.

Më 27 qershor të po këtij viti, Nezir Leskoviku do të njoftonte se përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme turke Nusret Beu i kishte bërë me dije se Ankaraja dëshironte të dërgonte Tahir Lutfi Beun në Tiranë si përfaqësues të shtetit turk<sup>96</sup>. Më datë 28 korrik 1925, vazhdimësinë e kësaj bisede e forcoi letra miqësore dërguar presidentit shqiptar, nga Mustafa Qemali. Me anën e saj ai bënte një ekspozë lidhjeve dhe forcimit të marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve e më pas i kërkonte Presidentit shqiptar leje për hapjen e një ambasade turke në Tiranë<sup>97</sup>.

Në raportin dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë nga Stambolli, do të konfirmohej se më 19 mars 1926, ministër i parë i Turqisë në vendin tonë ishte zgjedhur Tahir Lutfi Tokay. Ai ishte diplomat karriere dhe kishte shërbyer si ministër Fuqiplotë edhe në Beograd<sup>98</sup>. Tahir Lutfi Beu në historinë moderne të shtetit shqiptar është ambasadori i parë që u caktua në Shqipëri nga qeveria e Turqisë. Ai sillte edhe një letër të Ataturkut për Presidentin shqiptar Ahmet Zogun. Me anë të kësaj letre, Mustafa Qemali e falënderonte Ahmet Zogun për letren e tij, e uronte për zgjedhjen president, dhe shprehte ndjenjat dhe miqësinë e lartë për shqiptarët<sup>99</sup>. Detyra e Tahir Lutfiut, sipas Presidentit të Republikës Turke, ishte të vendoste lidhje diplomatike të përhershme për të konsoliduar marrëdhënie miqësore midis të dy vendeve<sup>100</sup>.

Më 9 prill 1926, si ministër i Shqipërisë në Turqi dhe Bullgari u emërua Rauf Fico, një ndër diplomatët e aftë shqiptarë i zgjedhur nga pala shqiptare, si personalitet i cili do të kontribuonte në lidhjen dhe forcimin më tej të marrëdhënieve midis dy vendeve. Më vonë ky diplomat do të emërohej ministër i Punëve të Jashtme të qeverisë

---

<sup>96</sup> *AQSH*, F.251, D.122, V.1925, Mbi përfaqësuesin që emëron Turqia në Shqipëri. Në momentin që po flasim Tahir Lutfi Beu ndodhej me detyrë në Beograd. Ai kishte kryer studimet në shkollën administrative “Mylkien” dhe ishte kryeredaktor i gazetës “Ikdam”.

<sup>97</sup> Bilal N. Simsir, *Atatürk ve yabancı Devlet Başkanları...*, Stamboll: 1993, f.292.

<sup>98</sup> *AQSh*, F.151, dok. 92, dt. 19 mars 1926, Tahir Lutfi Beu u caktua ambasador i Turqisë në Tiranë.

<sup>99</sup> *AMPJ*, D. 94, Letër për Ahmet Zogun nga Gazi Mustafa Qemali, më 22.12 1925.

<sup>100</sup> *AQSh*, F.151, V. 1925, fl.21-22, Letërkredencialet e dhëna në turqisht dhe frëngjisht nga M. Qemali, përfaqësuesit të Turqisë në Tiranë, 28.7.1925; Shih edhe *BCA*, 3921/ 62-78.

shqiptare. Në 13 mars 1926, Rauf Fico i paraqiti letratkredenciale Presidentit të Republikës Turke në Ankara<sup>101</sup>. Gjatë ceremonisë së dorëzimit, ai nënvizoi se do të përpiqej me të gjitha forcat “për të konsoliduar lidhjet e miqësisë që ekzistojnë prej shekujsh midis dy kombeve, që kanë pasur fate të përbashkëta gjatë rrjedhës së historisë”<sup>102</sup>. Ataturku e mirëpriti dhe iu përgjigj me këto fjalë: “Mund të jini të sigurtë se do të keni ndihmën time dhe të qeverisë Republikane në punën tuaj për konsolidimin e lidhjeve miqësore midis dy popujve, që kanë pasur fate të përbashkëta në shumë fusha në periudha tepër të hershme të historisë, në punën për t’u shërbyer interesave të të dy vendeve dhe për të çelur një periudhë bashkëpunimi të ngushtë midis dy kombeve”<sup>103</sup>.

Marrëdhëniet diplomatike shqiptaro-turke të vendosura plotësisht do të zgjasin vetëm për një periudhë të shkurtër dyvjeçare, sepse në Shqipëri forma institucionale e qeverisjes pësoi ndryshime. Shpallja e Mbretërisë Shqiptare nuk do të pritej mirë nga Mustafa Qemali, ç’ka do t’i hapi rrugë tensionimit të marrëdhënieve midis dy vendeve.

### *S u m m a r y*

#### THE ESTABLISHMENT OF ALBANIAN-TURKISH RELATIONS IN THE 1920’S

After the Conference of Ambassadors’ decision of 9 November 1921 about the recognition of Albania’s independence and its government, Tirana considered as a priority the establishment of diplomatic relations with other countries. In this context, the establishment of diplomatic relations with Turkey was considered of primary importance as a large group of Albanian immigrants,

<sup>101</sup> AMPJ, V. 1926, D. 40, fl.22-24, Letërkredencialet e Rauf Ficos, 17.1.1926; shih edhe Bilal N. Simşir, *Atatürk ve YabancıDevlet Adami Başkanlari-I*, T.T. K, Kültür Bakanlığı, Ankara: 1981, f.291

<sup>102</sup> AMPJ, V.1926, D. 40, fl.22-24, Fjalimi i Rauf Ficos, dt.13.3.1926; Shih edhe: Bilal N. Simşir, *Atatürk ve Yabancı...*, Ankara: 1981, f.292.

<sup>103</sup> AMPJ, V.1926, D. 40, fl.22-24; *po aty*, Përgjigje e Gaziut (M. Qemalit) drejtuar Rauf Ficos, dt.17.3.1926.

who had immigrated before 28 November 1912 but also after that date, lived and worked there.

These relations were considered important for Turkey as well. On 1<sup>st</sup> of March 1922, Mustafa Kemal Atatürk in a speech held in the General National Assembly speaking about the attitude of the Turkish people toward the Albanians, would stress the early ties and also the future of the relations between the two countries.

In December 1922, when Ahmet Zogu came to power, the interests of Albania and the situation inside the country required the establishment of balanced relations with the other Balkan countries. Under these new political circumstances, and with the added incentive of the Albanian immigrants in Turkey, the Albanian government would seek and try to establish the diplomatic relations with the Turkish government of Ankara.

After the official invitation of Ankara the Albanian government sent to the Turkish capital a delegation headed by Eshref Frasheri, speaker of the parliament. On 15<sup>th</sup> of December 1923 in Ankara, as a conclusion of prolonged talks were signed three agreements known as "*The Treaty of Friendship*". These three agreements were: the agreement on the establishment of diplomatic relations, the agreement on residency and the agreement on citizenship.

These agreements were not immediately implemented. First, they were ratified in February and April 1925 by the respective parliaments. However, these diplomatic relations would last only for a couple of years. The proclamation of the Albanian Monarchy in 1928 would not be welcomed by Mustafa Kemal Atatürk and this would cause tensions in the relations between the two countries.

